



Pranuar / Dorezuar Priljezat / Prodato Received / Delivery	04.12.2023	3	viti god. year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHK	7214/2023		1/7



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1245/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë; me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës A.nr.1245/2023, të datës 04.10.2023, të parashtruar nga ankuesi

në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 30.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1245/2023, e datës 04.10.2023, e parashtruar nga ankuesi**
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër Nr.54/2023, i datës 19.09.2023 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme.**

Arsyetim

Ministria e Punëve të Brendshme/ DMZP me datë 14.07.2023 ka njoftuar për shpalljen e konkursit me numër të referencës RN00012073 për grupin *Specialist i Administrimit të Përgjithshëm*, për pozitën “Inspektor i Tregut”, me mundësi aplikimi nga datës 04.08.2023 deri me datën 11.08.2023, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi. Sipas vendimit me numër 327/2023 të datës 08.09.2023 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë ankuesit i është refuzuar aplikacioni me arsyetim se i njëjti nuk ka ofruar dëshmitë e kërkuara sipas konkursit respektivisht nuk ka dorëzuar dokumentet si në vijim: kopjen e dëshmisë së punësimit (se paku dy (2) vite përvoje punë profesionale në fushën në të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lire të punës) të cilave u bashkëngjitet se paku njëra nga dëshmitë mbështetëse si në vijim; pasqyrën e pagesave në fondin e kursimeve pensionale, pasqyrën

e pagesave te obligimeve tatimore ne përputhje me legjislacionin tatimore për të ardhura personale (vërejtje: nuk vlen vetëm vërtetimi dhe apo vetëm dokumenti mbështetës, është i nevojshëm ngarkimi në sistem i të dy llojeve të dokumenteve: vërtetimi si dëshmi kryesore dhe njëra nga pasqyrat si dëshmi mbështetëse), Certifikatën/Vërtetimin nga Gjykata ose nga Këshilli Gjyqësore i Republikës së Kosovës me të cilën dëshmohet se nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale me dashje, jo me e vjetër se gjashtë (6) muaj si dhe dokumentin apo dëshminë nëse përvoja e punës është në sektorin publik atëherë është i nevojshëm vërtetimi nga institucioni ku ka punuar kandidati me të cilin dëshmohet e ai nuk ka një masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozitë e zyrtarit publik të pushuar sipas Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, nëse përvoja e punës është deklaruar ne sektorin privat brenda apo jashtë vendit në një OJQ brenda a po jashtë vendit po angazhim nga i cili rrjedhe përvoja e punës atëherë është e nevojshme një vetë deklaram i nënshkruar nga kandidati se nuk ka masë disiplinore .

Ankuesi i pa kënaqur me vendimin me numër 327/2023 të datës 08.09.2023 të Divizionit për Zhvillimin Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik me datë 12.09.2023 ka parashtruar ankesë pranë Departamentit për Menaxhimin për Zyrtar Publik. Ndërsa kjo e fundit me datë 19.09.2023 përmes vendimit me numër Nr.54/2023 ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar.

Ankuesi i pa kënaqur me vendimin me numër Nr.54/2023 të 19.09.2023 të Divizionit për Zhvillimin Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, me date 04.10.2023 ka parashtruar ankesën me numër, protokolli 6380/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me pretendim ankimore se me rastin e aplikimit me date 09.08.2023 ankuesi ka dorëzuar te gjitha dëshmitë të kërkuara sipas konkursit të datës 14.07.2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 09.10.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publik, ndërsa, ky i fundit me datë 12.10.2023, ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Sipas kërkesës së anëtarëve të Kolegjit, me datë 16.11.2023 Kryetari i Këshillit ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2023 dhe numër protokolli:7015/2023, përmes së cilit ankesës së ankuesit A.nr.1245/2023 të datës 04.10.2023 ia ka vazhduar afatin vendimmarrës edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 6380/2023 të datës 04.10.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Te dhënat e aplikimit te dorëzuara nga ankuesi (pa date); dokumentin pa datës dhe numër te nxirr nga Sistemi Informativ për Menaxhimin Burimeve Njerëzore; Diplomën me numër 4472 të datës 18.01.2017; Pasqyrën e llogaris Trustin e datës 20.12.2012 deri me datën 02.08.2023; Kërkesën për sqarim të datës 07.08.2023; Emalin e datës 21.09.2023; Emalin e datës 08.08.2023 të A.Xhemajli drejtuar Njesisë se Burimeve Njerëzore; Emalin e datës 09.08.2023 te Njesisë së Burimeve Njerëzore drejtuar D.Xhemajli; Emalin e datës 09.08.2023 të D.Xhemajli drejtuar Njesisë së Burimeve Njerëzore; Referencën e datës 01.10.2020; Letër Referencën e datës 30.09.2020;Referemncen e datës 30.01.2015; Certifikatën pa (date dhe numër); Certifikatën datës 11.04.2017; Certifikatën pa (date dhe numër); Certifikatën pa (date dhe numër); Certifikatën e

datës 30.03.2012; Certifikatën e datës 10.05.2018; Certifikatën e datës 07.08.2023 mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës; Vendimin me Nr.327/2023 të datës 08.09.2023 lidhur me refuzimin e aplikacionit të ankuesit; Vendimin me Nr.54/2023 të datës 19.09.2023 lidhur me refuzimin e ankesës së ankuesit; Ankesën e datës 12.09.2023 të parashtruar nga ankuesi të organi i punësimit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 09.10.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 12.10.2023; Konkursin me numër të referencës RN00012073 të datës 14.07.2023; Vendimin me Nr.02/164 të datës 09.10.2023; Listën e kandidatëve të aprovuar; Njoftimin e datës 11.09.2023; Plotësim ndryshimin e listës së ngushte të datës 19.09.2023; Aplikacionin e datës 09.08.2023 të ankuesit; Certifikatën e lëshuar në Nentor-2015; Emalin e datës 24.11.2023 të H.Zuban drejtuar I. Mehmeti; Emalin e datës 23.11.2023 të I. Mehmeti drejtuar S. Krasniqi;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës konstatoi së janë të *pabazuara* pretendimet ankimore të ankuesit, *sepse*:

Kolegji i Këshillit nga provat e administruara të lëndës ka gjetur se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publik, me datë 14.07.2023 (afati për aplikim 04.08.2023 – 11.08.2023) ka shpallur konkursin e jashtëm për praninë me numër të referencës RN00012073, për grupin *Specialistë i Administrimit të Përgjithshëm*, në Ministrinë e Industrisë Ndërmarrëses dhe Tregtisë/ respektivisht Inspektoratin e Tregut në pozitën "*Inspektor i Tregut*". Rrjedhimisht, sipas Vendimit Nr. 327/2023 të datës 08.09.2023, rezulton se ankuesi nuk është përfshirë në listën e ngushtë për të vazhduar në fazën tjetër të procedurës për pozitën përkatëse të punës, me arsyetimin se i njëjti me rastin e aplikimit nuk ka bashkëngjitur dëshmitë e kërkuara sipas konkursit si në vijim: kopjen e dëshmisë së punësimit (se paku dy (2) vite përvoja punë profesionale në fushën në të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lire të punës) të cilave u bashkëngjitet se paku njëra nga dëshmitë mbështetëse si në vijim; pasqyrën e pagesave në fondin e kursimeve pensionale, pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimore për të ardhura personale (vërejtje: nuk vlen vetëm vërtetimi dhe apo vetëm dokumenti mbështetës, është i nevojshëm ngarkimi në sistem i të dy llojeve të dokumenteve: vërtetimi si dëshmi kryesore dhe njëra nga pasqyrat si dëshmi mbështetës), Certifikatën/Vërtetimin nga Gjykata ose nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës me të cilën dëshmohet se nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale me dashje, jo me e vjetër se gjashtë (6) muaj si dhe dokumentin apo dëshminë nëse përvoja e punës është në sektorin publik atëherë është i nevojshëm vërtetimi nga institucioni ku ka punuar kandidati me të cilin dëshmohet e ai nuk ka një masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozitë e zyrtarit publik të pushuar sipas Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, nëse përvoja e punës është deklaruar në sektorin privat brenda apo jashtë vendit në një OJQ brenda a po jashtë vendit po angazhim nga i cili rrjedhe përvoja e punës atëherë është e nevojshme një vetë deklaram i nënshkruar nga kandidati se nuk ka masë disiplinore .

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin Nr.327/2023 të datës 08.09.2023, ka parashtruar ankesë pranë Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, ndërsa kjo e fundit me Vendimin me numër Nr.54/2023, të datës 19.09.2023, ka refuzuar si të pabazuar ankesën me arsyetimin e njëjte dhe është vlerësuar se pala nuk i ka përmbushur kushtet për përfshirjen në listën e ngushtë.

Në kontekst të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji ka analizuar konkursin për grupin „*Specialistë i Administrimit të Përgjithshëm* “ për pozitën "*Inspektor i Tregut*" dhe ka konstatuar se si kërkesa të përgjithshme formale për këtë pozitë të punës kanë qenë:

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve në fushat; Arsim i Lartë i pa specifikuar;*
- *Kualifikime të posaçme formale: nuk ka;*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Se paku (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës;*

Në pikën 7 të këtij konkursi si dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim janë: *Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore, nostrifikimin apo aktin që dëshmon se diploma e marrë jashtë vendimit është ne procedure te nostrifikimit; Kopjen e dëshmisë së punësimit të bashkangjitur se paku njëra nga dëshmitë mbështetëse si ne vijim; pasqyrën e pagesave ne fondin e kursimeve pensionale, pasqyrën e pagesave te obligimeve tatimore ne përputhje me legjislacionin tatimore për të ardhura personale (vërejtje: nuk vlen vetëm vërtetimi dhe apo vetëm dokumenti mbështetës, është i nevojshëm ngarkimi në sistem i të dy llojeve të dokumenteve: vërtetimi si dëshmi kryesore dhe njëra nga pasqyrat si dëshmi mbështetëse; Kopjet e dëshmisë së trajnimeve te ndjekura apo trajnimeve qe aplikuesi i ka realizuar ne cilësinë e trajnuesit; Dëshmi mjekësorë se kandidati është ne gjendje shëndetësore për te kryer detyrat; Certifikatën /vërtetimin nga Gjykata ose Këshilli Gjyqësore i Republikës se Kosovës me të cilin dëshmohet se nuk jeni dënuar me vendim te formës se prere për kryerjen e një vepre penale me dashje jo me te vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit; ; Nëse kohëzgjatja lidhur me përvojën e punës, është ne sektorin publik, atëherë është i nevojshëm vërtetimi nga institucioni ku ka punuar kandidati me te cilin dëshmohet se ai nuk ka një mase disiplinore ne fuqi për largim nga një pozite e zyrtarit publik te pushuar sipas ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik; Nëse përvoja e punës e deklaruar është ne sektorin privat brenda apo jashtë vendit ne një OJQ brenda apo angazhimi nga i cili rrjedhe përvoja e punës ne ndonjë forme e marrëdhënies kontraktuale qe nuk nënkupton marrëdhënie pune, atëherë është i nevojshëm një vete deklarim i nënshkruar se ajo nuk ka një mase disiplinore ne fuqi për largim nga një pozite e zyrtarit publik te pushuar sipas ligjit NR.06/L për zyrtar Publik.*

Në kuptim të kërkesave të përgjithshme formale për pranimin e zyrtarëve publikë të paraparë me nenin 8 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konkretisht me paragrafin 1, përcaktohet se: *“Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë janë: 1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë për të vepruar; 1.3. të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji”,* ndërsa sipas nenit 12 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *“2. Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e konkurrimit, kandidatët duhet të bashkëngjitin edhe dokumentacionin si në vijim: 2.1. kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit, dhe 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurrimit dhe të deklaruara në aplikacion”.*

Bazuar në dispozitat e cekura më lartë, e që kanë të bëjnë me kërkesat për pranim në shërbimin civil, Kolegji i Këshillit, konstaton se në bazë të provave të lëndës, konkretisht dokumentacionit që ka dorëzuar ankuesi, me rastin e aplikimit lidhur me plotësimin e kriterit të kualifikimit arsimor i njëjti ka dorëzuar Diplomën me Nr.4472, të datës 18.01.2017 me të cilën vërtetohet se i njëjti me datë 19.04.2016, ka përfunduar Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës nga rrjedhë se i njëjti ka plotësuar kriterin e vendosur në aspektin e kualifikimit arsimor. Ndërsa, sa i përket kriterit të përvojës së punës si dëshmi te cilat organi i punësimit i ka ofruar Këshillit te Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil te Kosovës përmes përgjigjes ne ankese i njëjti nuk ka ofruar Pasqyrën e Trustit

Pensional si dhe asnjë vërtetim me të cilën dëshmohet se i njëjti ka përvojë pune, respektivisht me rastin e aplikimit kërkohet që kandidatet përveç dëshmisë se Trustit Pensional duhet ti bashkëngjisin edhe vërtetimin si dëshmi nga punëdhënësi që specifikon pozitën, detyrat dhe kohën e angazhimit të tij në atë pozitë, standard ky i cili është përcaktuar sipas Aktvendimit me numër AA.nr.614/2022 të datës 27.09.2022 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës. Ndërsa lidhur me kërkesën në klauzolën nr. 7 të konkursit të lartpërmendur, përkitazi me vet deklarimin se kandidati nuk ka një masë disiplinore në fuqi për lagim nga një pozitë e zyrtarit publikë, Kolegji ka konstatuar se edhe pse ankuesi në aplikacion ka shënuar se ka punuar në sektorin privat përkundër kësaj i njëjti nuk ka ofruar asnjë vërtetim nga institucionet ku ka punuar dhe po ashtu nuk ka dorëzuar një vetë deklaram të nënshkruar nga ai me të cilin dëshmohet se ai nuk ka një masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozite e zyrtarit publik të pushuar sipas Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se ankuesi, me rastin e parashtrimit të ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka dorëzuar edhe dokumente apo dëshmi tjera konkretisht: Referencë të lëshuar nga Kompania „MEKA SHPK“; Letër referencë të datës 30.09.2020 të lëshuar nga Kompania „FLUIDI SHPK“; Reference të datës 30.01.2015 të lëshuar nga Drejtoria për Financa dhe Prone e Komunës së Prishtinës; Pasqyrën e llogarisë së Trustit Pensional për periudhën 20.12.2012 deri me datë 02.08.2023 me të cilat ka dëshmuar përvojën e punës, po ashtu i njëjti ka dorëzuar Certifikatën/Vërtetimin e datës 07.08.2023 nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës me të cilën dëshmohet se ankuesi nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë, mirëpo të njëjtat këto dokumente ankuesi nuk i ka dorëzuar me rastin e aplikimit për emrin e grupit „Specialistë i Administrimit të Përgjithshëm“ respektivisht për pozitën „Inspektor i Tregut“ të shpallur sipas konkursit të datës 14.07.2023 me numër të reference RN00012073 nga Ministria e Punëve të Brendshme, ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 12 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku ky fakt është vërtetuar edhe në bazë të dëshmimeve të ofruara nga organi i punësimit gjegjësisht në bazë të aplikacionit të tij po ashtu edhe në bazë të emalit të datës 24.11.2023 të dërguar në Këshill nga zyrtarja e DMZP-së H. Zuban, e cila ka deklaruar se sipas kërkesës suaj dhe pas shqyrtimit edhe një here të të gjitha dokumenteve gjate aplikimit të ankuesit z. ju informoj se ankuesi me rastin e aplikimit nuk i ka bashkëngjitur dokumentet të cilat nevojiten për të dëshmuar se i plotëson kriteret e konkursit respektivisht ankuesi me rastin aplikimit nuk ka dorëzuar këtë dokumente: Kopjen e dëshmisë së punësimit (se paku (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e vendeve të lira të punës) të cilave i bashkëngjitet se paku njëra nga dëshmitë mbështetëse si në vijim; pasqyrën e pagesave në fondin e kursimeve pensionale, pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimore për të ardhura personale. Ndërsa ankuesi po ashtu me rastin e aplikimit nuk ka ofruar Certifikatën/Vërtetimin nga Gjykata ose nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës me të cilën dëshmohet se nuk është dënuar me vendim të formës së prerë, për kryerjen e një veprë penale me dashje, jo me e vjetër se gjashtë (6) muaj si dhe nëse përvoja e punës së deklaruar është në sektorin privat, brenda apo jashtë vendit, në një OJQ brenda apo jashtë vendit apo angazhimi nga cili rrjedhë përvoja e punës është formë e marrëdhënies kontraktuale që nuk nënkupton marrëdhënie pune, atëherë është i nevojshëm një vetë deklaram i nënshkruar si ai/ajo nuk ka një masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozitë e zyrtarit publik e pushuar sipas Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publik.

Duke marrë parasysh faktet e lartpërmendura dhe vlerësimin e provave të lëndës respektivisht dëshmitë e dërguar nga ankuesi me rastin e aplikimit, rrjedhë se ankuesi nuk ka përmbushur kriteret për të kaluar fazën e verifikimit paraprak ngase nuk ka dëshmuar me prova materiale

gjegjësisht nuk ka ofruar dëshmi lidhur me përvojën e punës, nuk ka ofruar Certifikatën e lëshuar nga Këshilli i Gjyqësore i Republikës Kosovës, me të cilën dëshmohet se nuk është dënuar me vendimin formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, si dhe po ashtu nuk ka ofruar një vetë deklaram të nënshkruar nga vetë ankuesi se i njëjti nuk ka masë disiplinore në fuqi për largim nga pozita e zyrtarit publik, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se vendimi i kundërshtuar me ankesë respektivisht Vendimi me numër Nr.54/2023, i datës 19.09.2023 dhe Vendimi me numër Nr.327/2023 i datës 08.09.2023 i Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit është i drejtë dhe i ligjshëm, sepse të njëjtit janë nxjerr në frymën ligjore dhe mbi bazë të gjendjes faktike dhe duke u respektuar kompetenca dhe hierarkia ligjore e përcaktuar me nenin 34 paragrafi 7 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 12 paragrafi 2 nën paragrafi 2.3, nenin 15 paragrafi 1,2,3,5 dhe 6 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet së: *1.Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim.2.Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak. 3.Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin në fazën e mëtejshme, e cila njihet si lista e ngushtë...” 5.Kandidatë, që nuk plotësojnë kushtet për aplikim në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin. Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe u njoftohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se katërmëdhjetë (14) ditë kalendarike nga data përfundimtare e pranimit të aplikacioneve. 6.Brenda tre (3) ditëve nga data e njoftimit individual, në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, kandidatët e njoftuar që nuk plotësojnë kushtet e aplikimit, kanë të drejtë të paraqesin ankesë të brendshme. Ankesa parashtrohet me shkrim pranë Njesisë Përgjegjëse. Ankesa shqyrtohet nga Njësia Përgjegjëse e cila me vendim e njofton kandidatit brenda pesë (5) ditëve nga paraqitja e saj”, dhe po ashtu i njëjti është i arsyetuar në pajtim me dispozitat e nenit 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.*

Kolegji i Këshillit, nga konstatimi si më lartë, thekson faktin se me vendimin e kundërshtuar me ankesë, ankuesit nuk i është cenuar asnjë e drejtë nga e drejta për t’iu nënshtruar procedurave të tjera të pranimit ngase obligimi për të dorëzuar dokumentacionin së bashku me aplikacionin është obligim i kandidatit, si rezultat i kësaj Kolegji i Këshillit konstaton se të gjitha pretendimet e ankuesit janë të pabazuara për shkak që nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe faktike, sepse refuzimi i aplikacionit të ankuesit nuk është bërë për shkak të mos plotësimit të kriterëve në aspektin e përgatitjes profesionale apo në aspektin e mos përmbushjes së përvojës së punës por është bërë vetëm që nuk ka dorëzuar dëshminë e cekur si ma lartë.

Theksuar si më sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1245/2023

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.